

VENDIM
Nr.890, datë 22.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE TË SHËRBIMIT INFORMATIV KOMBËTAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë i pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin), për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, janë përkatësisht sipas Lidhjes nr.1, “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Niveli më i ulët i pagës (Klasa I) bëhet 10 800 (dhjetë mijë e tetëqind) lekë në muaj, ndërsa niveli më i lartë (Drejtor drejtorie në bazë, zëvendës drejtor drejtorie në aparat qendror dhe në Drejtorinë e Tiranës, Klasa XII), bëhet 38 500 (tridhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë në muaj.”.

b) Paragrafi i dytë i pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, në varësi të vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, për Shërbimin Informativ të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT E SHERBIMIT
INFORMATIV TE SHITESIT

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11300
4.	IV	11500
5.	V	11700
6.	VI	12000
7.	VII	12500
8.	VIII	12900
9.	IX	13400
10.	X	13900
11.	XI	14500
12.	XII	15100
13.	XIII	15900
14.	XIV	17000
15.	XV	19000
16.	XVI	20000
17.	XVII	21500
18.	XVIII	24000
19.	XIX	27000
20.	XX	30000
21.	XXI	33500
22.	XXII	38500